14/12/2021
01-060/03-0108140/21

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 42.5 dhe 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neneve 4 paragrafi 6 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neneve 36 paragrafi 5 dhe 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.0 l/ 146-11 të datës 29 prill 2010, në kërkesë dhe koordinim me Kryetarin e Komunës,

**T H I R R E T**

Mbledhja e II-të (dytë) - e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Podujevës - mandati i VII, e cila do të mbahet më **17 dhjetor 2021,** në sallën e Kuvendit, në orën **10;00,** me këtë;

## Rend dite

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës
   - *Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit*
   - *Propozimi i kandidatëve*
   - *Procesi i votimit*
   - *Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit*

2. Themelimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa

**Shtojcë:**
***Propozimi për themelimin dhe përbërjen e komitetit për politikë dhe financa***

**Podujevë,**
**14 dhjetor 2021**

**Anëtari më i moshuar i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 51.1 dhe 52.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 5 dhe 6 të Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, si dhe neneve 14, 47 paragrafi 1 dhe 48 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, i,

***PROPOZOHET***

## VENDIM
## PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

**Neni 1**

Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

1- ______________________________ Kryesuesi i Kuvendit (sipas pozitës)
2-______________________________ nga subjekti politik_______
3-______________________________ nga subjekti politik_______
4-______________________________ nga subjekti politik_______
5-______________________________ nga subjekti politik_______
6-______________________________ nga subjekti politik_______
7-______________________________ nga subjekti politik_______
8-______________________________ nga subjekti politik_______
9-______________________________ nga subjekti politik_______

**Neni 2**

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlidhet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

**Neni 3**

Komitetit për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera në fuqi.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Podujevë, 14 dhjetor 2021**